



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun
Subjekti: Ngritja e tarifave të energjisë elektrike

Prishtinë, 26 qershor 2008

Reagim **Aleanca Kosova e Re**

Vendimi i Bordit të ZRRE për rishikimin e tarifave të energjisë elektrike për vitin 2008, dhe ngritjen e tyre për mesatarisht, rreth 5%, do të mund të ketë pasoja negative edhe për vet Korporatën Energjetike të Kosovës dhe Ministrinë e Energjetikes, e cila për momentin nuk ka fare strategji afatshkurtër, se si të dalë nga kjo situatë.

Në këtë kohë, Kosova po kalon neper krizën më të madhe energjetike të pasluftës :

- blloqet e Kosovës B, janë më shume nën remont se sa në punë,
- blloqet e Kosovës A, prodhojnë sasi te vogla te energjisë, por nuk dihet për sa kohë,
- Mihjet sipërfaqësore të thëngjillit mezi po furnizojnë këtë numër të vogël të blloqeve që janë në punë,
- pajisjet kapitale në elektrane si: kaldajat, gjeneratorët dhe transformatorët, janë stërvjetruar dhe riparimet e pjesshme të tyre nuk kanë kuptim,
- reduktimet e energjisë elektrike në shumë rajone të Kosovës janë 4:2 në favor të territorit,
- humbjet teknike dhe komerciale janë në rritje e sipër,
- inkasimi i energjisë së prodhuar dhe shpenzuar mezi mbërrin shifër 45%,
- punëtorët e Elektraneve hynë në greve dhe pas dy ditësh merret vendim të ndërpritet greva me marrëveshje mes bordit dhe menaxhmentit. Kjo krijon dilema se a është bordi më i rëndësishëm se "Qeveria".

Bordi i ZRRE del me vendim për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Çështja është se kjo ngritje prej 5% e energjisë elektrike, do të zgjidhë problemet e lartpërmendura apo vetëm do t'i përtërij ato:

- bizneset e vogla dhe të mesme Kosovare, që paguajnë energjinë elektrike me besueshmëri më të ultë e me çmime më të larta, se sa Feronikeli që ka furnizim të pandërprerë.
- Sa do të jetë kjo në dobi të Qeverisë dhe KEK-ut, nëse mbetet kjo ngritje e tarifave kur dihet fare mire sa është numri i të punësuarave në Kosovë dhe sa është inflacioni në rritje.

ZRRE, është zyre e cila duhet të merret edhe me mbrojtjen e konsumatoreve, jo vetëm me mbrojtjen e KOSST-it.

Esenciale për momentin, duhet të jetë zbritja e çmimit të energjisë elektrike, që të gjithë konsumatorët të jenë në sistemin e parapagimit dhe njëkohësisht të ngrihen të gjitha borxhet.

Pavarësisht pagesave të faktuarve të KEK nga ana e qytetarëve, Qeveria e Kosovës i ka ndarë KEK-ut 84 milion nga taksat e qytetarëve.

Myzejene Selmani,

Deputete e Grupit Parlamentar të AKR-së.

Kryetare e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.